Nëntor 2010



Përforcimi rolit të RIA[1] në procesin e krijimit të politikave në Maqedoni

[1] RIA është shkurtesa e termit të plotë
Regulatory Impact Assessment (Vlerësimi i ndikimit rregullator)

Mirënjohje

Raporti “Përforcimi i rolit të Vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA) në procesin e krijimit të politikave në Maqedoni” është pjesë e programit TRAIN, i finansuar nga Këshilli gjerman për politikë të jashtme (DGAP) dhe është i përgaditur nga dy hulumtuesit e Analytica-s, Agim Selami dhe Sonja Risteska, nën mentorim të z. Veli Krecit. Në përpunimin e suksesshëm të këtij raporti, kontribut të veçantë dhanë edhe Neda Malevska, Natalija Shikova, Marjana Jovanovska, Maja Simonovska, Jadranka Ivanova, Mirsat Esati, Teuta Neziri, dhe Aleksandar Popovski.

Përmbajtja

1. Hyrje....3
2. RIA në Maqedoni....5
   2.1 RIA nëpër dokumente më të rendesishme....6
   2.2 Llojet e RIA....9
   2.3 Procesi i konsultimeve....10
3. Të arriturat e deritanishme dhe sfidat e mëtutjeshme....11
   3.1 Të arriturat më të rëndësishmë....11
   3.2 Sfidat e mëtutjeshme....12
4. Rekomandime konkrete dhe konkluza....14
5. Bibliografia....15

1. Hyrje

Qëllimet e këtij raporti janë trajtimi i aspekteve më të rëndësishme të procesit të inaugurimit dhe implementimit të RIA-s në Maqedoni si dhe kryerja e një analize të detajuar të procesit në tërësi. Bazuar në analizën e bërë, tentohet që të vërtetohet progresi i arritur dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky proces, shoqëruar me rekomandime konkrete për eliminim të pengesave të identifikuara. Raporti është hartuar në bazë të kombinimit të intervistave me aktorë kyç në procesin e RIA-s në Maqedoni, hulumtimeve desktop si dhe analizave komparative me shtete tjera.

Qeveritë e vendeve të ndryshme të botës ballafaqohen në mënyrë të vazhdueshme me trendin e rritjes së sasisë së politikave, ligjeve dhe akte tjera ligjore. Ky trend është padyshim më i theksuar në shtete me demokraci të brishtë dhe ta pakonsoliduar, ku përveç problemit të madhësisë së rregullativës ekzistuese, paraqitet edhe çështja e kualitetit të tyre, sinkronizimit të tyre me rrethanat aktuale në vend si dhe efektet që ato prodhojnë.

Miratimi i rregullativës së re, ose analizimi i asaj ekzistuese duhet të ketë një pikësynim të vetëm: zgjidhjen efikase të problemeve që dalin nga një sferë e caktuar shoqërore si për palët e involvuara drejtpërsëdrejti, ashtu edhe për shoqërinë si tërësi. Për realizimin e këtij qëllimi, nevojitet që të bëhet një analizë e detajuar, përfshirë rrethanat e jashtme dhe të brendshme të problemit që po trajtohet, të gjenden zgjidhje rregullatore ose jorregullatore, të bëhet analizë e palëve të involvuara, si dhe më e rëndësishmja, të identifikohet zgjidhja më e përshtatshme nga aspekti buxhetorë me çka nuk do të krijoheshin implikacione shtesë të natyrës finansiare. Përgjigjet e këtyre pyetjeve në mënyrë më precize jepen përmes hartimit të dokumentit për Vlerësim të ndikimit rregullator (mëtej:RIA), i njohur më shumë si Regulatory Impact Assessment.

RIA paraqet instrument të cilin vendim-marrësit e përdorin për të parashikuar dhe vlerësuar impaktet e mundshme të rregullativës ekzistuese ose të propozuar mbi aspektet politike, socio-kulturore, ekonomike si dhe ekologjike. Një definicion tjetër i rëndësishëm për RIA është se ky paraqet aktivitet sistematik rregullator i cili nuk mund assesi të llogaritet si zëvendësim i procesit të tërësishëm të krijimit të politikave.

Përkundrazi, RIA duhet të jetë element përbërës i këtij procesi dhe të kontribuojë pozitivisht në debatin lidhur me rregullativën e propozuar. [2]

Procesi i hartimit të RIA-s bazohet në vënien në funksion të principeve të OECD për rregullativë më efikase dhe më kualitative si: definimi i problemit, identifikimi i shpenzimeve, identifikimi i beneficioneve që dalin nga rregullativa, distribuimi i efekteve, konzistenca dhe gjithëpërfshirja e rregullativës, mundësia për përfshirje të palëve të interesuara në procesin e konsultimeve, dhe identifikimi i mënyrës së implementimit të rregullativës.[3]

Një fakt i rëndësishëm në lidhje me RIA është se numri i shteteve që e miratojnë RIA është vazhdimishtë në rritje, dhe asnjëri nga shtetet që njëherë e ka miratuar atë, nuk ka vendosur që ta heqë nga procesi i krijimit të politikave. Përsa u përket përvojave të secilit shtet në veçanti në lidhje më zhvillimin e RIA, është e rëndësishme të potencohet se secili nga shtetet paraqet "përrallë më vete". Kjo kryesisht është si rezultat i asaj që shtrirja, forma, përmbajtja dhe roli i RIA ndryshon në varësi të procesit të krijimit të politikave në çdo shtet. Mu për këtë qëllim, përpjekjet e OECD-së kohëve të fundit janë të fokusuara kah standardizimi i procesit të RIA kudo në botë.

Vullneti i dobët politik nga ana e qeverive për integrim të RIA në procesin e krijimit të politikave paraqet problem shumë të theksuar. Edhe kur vendosin që të ndërmarrin një hap të tillë, qëllimi i tyre qëndron më shumë në legjitimim të tyre në kontekst ndërkombëtar sesa në pasjen e një pasqyre të qartë mbi përfitimet dhe mundësitë që dalin nga procesi i RIA.[4]

Aktor kyç në procesin e RIA gati se në çdo vend ku përgaditet RIA paraqitet qeveria së bashku me secilën nga ministritë. Megjithatë, edhepse ekzekutimi i kontrollit të RIA nga ana e parlamentit nuk është praktikë e rregullt thuajse në asnjë shtet ku RIA implementohet, në disa shtete të zhvilluara si SHBA dhe Italia, parlamenti përmes kqyrjes në RIA dokumentet e përgaditura, e përcakton kualitetin e aktit të propozuar. Më tej, thuhet se përforcimi i kapaciteteve të parlamentit për përgaditje të RIA është i

[2] Regulating Better: A Government White Paper setting out six principles of Better Regulation. January 2004. http://www.betterregulation.ie/eng/Government_Ëhite_Paper_'Regulating_Better'/RegulatingBetterGovernmentWhitePaper1.pdf. I hapur për së fundi më 02 Nëntor, 2010.

[3] The 1995 OECD Checklist for Regulatory Quality. http://www.oecd.org/officialdocuments/displaydocument/?doclanguage=en&cote=OCDE/GD(95)95, I hapur për së fundi më 03 Nëntor, 2010

[4] Katarina Staronova, Jan Pavel and Katarina Krapez 2007. *Piloting regulatory impact assessment: a comparative analysis of the Czech Republic, Slovakia and Slovenia.* <http://docserver.ingentaconnect.com/deliver/connect/beech/14615517/v25n4/s3.pdf?expires=1287494698&id=59202844&titleid=896&accname=Guest+User&checksum=F040D819503696D0E3873A8E210ECBC3> I hapur për së fundi më 19 Tetor 2010.

një rëndësie të veçantë për vendet në të cilat një përqindje e lartë e legjislacionit të propozuar rrjedh nga parlamenti.

2. RIA në Maqedoni

Krahasuar me shtetet e OECD, Maqedonia nuk ngel shumë prapa në inaugurimin e RIA. Inflacioni rregullator, joefikasiteti i rregullativës, rekomandimet e vazhdueshme nga ana e organizatave ndërkombëtare, si dhe vullneti i mirë politik nga ana e autoriteteve për inaugurim të RIA, janë disa nga arsyet kryesore që çuan deri te inicimi i këtij procesi.

Sipas Metodologjisë për vlerësim të ndikimit rregullator[5], përfitimet kryesore nga inaugurimi i RIA në Maqedoni janë: analizë e detajuar dhe e kompletuar e ndikimeve që dalin nga rregullativa; si dhe transparencë dhe konsultime si interne (ndërmjet ministrive) ashtu edhe eksterne (me palë të interesuara).

RIA në Maqedoni është pjesë e reformës më të gjerë rregullatore, e cila filloi në vitin 2006. Kjo reformë është ende në progres dhe është e ndarë në dy faza. Gijotina regullatore i përket fazës së parë, ndërsa RIA fazës së dytë. Më konkretisht, RIA është pjesë e projektit Ndërtimi i kapaciteteve administrative për integrime europiane, i përkrahur nga fondi SPFRE (Fond për bashkim të sërishëm të Evropës), dhe i implementuar në bashkëpunim me qeverinë. Së bashku me Planifikimin strategjik, bën pjesë në komponentin Përmirësim të legjislacionit dhe procedurave.

Metodologjia për RIA parasheh që procesi i hartimit të RIA të zhvillohet në katër faza, edhe atë:

1. Planifikimi: përfshin aktivitetet të cilat i ndërmerr secila ministri në procesin e hartimit të planit vjetor për punë dhe përgaditjeve të ligjeve.

2. Realizimi: përfshin aktivitetet të cilat i ndërmerr secila ministri në procesin e hartimit të propozim-ligjit, siç janë: konsultimet interne ndërmjet ministrive, konsultimet eksterne ndërmjet palëve të interesuara, si dhe shpallja publike e të gjitha informatave relevante në lidhje me propozim-ligjin në Regjistrin e vetëm elektronik të akteve (ENER)[6].

3. Ndjekja: përfshin aktivitetet që realizohen në Sekretariatin gjeneral në funksion të koordinimit dhe përshtatjes së zgjidhjeve të ofruara në propozim-ligj si dhe parashtrimin e tij për shqyrtim në seancë qeveritare.

[5] Metodologjia për vlerësim të ndikimit rregullator, Gazeta zyrtare e RM, numër 66, 28.05.2009

[6] www.ener.gov.mk

4. Përmirësimi: përfshin aktivitetet në kompetencë të ministrive dhe Sekretariatit gjeneral për ndjekje dhe analizë të efekteve që dalin nga ligji. Vlerësimi i efekteve bëhet brenda një afati kohor të caktuar paraprakisht, zakonishtë një vit nga hyrja në fuqi e ligjit, dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit, merret vendimi nëse do të ndërmerren hapa për ndryshim dhe plotësim të ligjit.[7]

Parashtrimi i RIA së bashku me ligjin e propozuar u bë obligativ duke filluar nga 1 janari i vitit 2009. Bazuar në zhvillimet e deritanishme të këtij procesi, vlerësimet janë nga më të ndryshmet. Ajo që është evidente është se RIA formularët[8] dorëzohen së bashku me çdo propozim-ligj të dorëzuar, megjithatë ekzistojnë dallime të shumta në lidhje me kualitetin e tyre. RIA më kualitative dhe më të detajuara përgaditen në ministritë të punësuarit e të cilave u janë nënshtruar trajnimeve të ndryshme nga ana e konsultantëve/ekspertëve të jashtëm.

Problemet kryesore të identifikuara deri më tani në implementimin e suksesshëm të RIA janë mungesa e kuadrove të trajnuara mirë për hartim të RIA, si dhe mosnjohja e domethënies dhe beneficioneve në mënyrë të hollësishme të cilat dalin nga RIA, nga ana e autoriteteve.

Një problem shtesë paraqitet në procesin e hartimit (shkruarjes) së ligjeve nëpër ministri. Në disa raste, edhepse ligji miratohet sipas procedurës së zakonshme, koha e cila u jepet në dispozicion ministrive për të hartuar ligjin, është thuajse e barabartë me atë të sjelljes së ligjit sipas procedurës së përshpejtuar. Ky problem është padyshim më i shfaqur në raste ndryshimesh dhe plotësimesh të ligjeve. Si pasojë e kësaj, propozuesit të ligjit nuk i jepet kohë e mjaftueshme për të hartuar RIA të detajuar, duke i dhënë këtij instrumenti vetëm domethënie teknike dhe formale.

Për dallim nga vendet me traditë më të begatë të RIA, ku ky dokument hartohet për politika, projekte, akte ligjore dhe nënligjore, për rregullativë ekzistuese dhe të re, ex-ante dhe ex-post, në Maqedoni domosdoshmëria për të parashtruar RIA vlen vetëm për ligje që miratohen sipas procedurës së rregullt.

2.1 RIA nëpër dokumente më të rëndësishme

Ashtu si u tha më lartë, RIA lirishtë mund të llogaritet si komponentë e integruar në tërë procesin e krijimit të politikave. Kjo megjithatë është si rezultat i miratimit të disa elementeve kyçe lidhur me RIA, gjë që çoi deri te formalizimi i përcaktimit të qartë të qeverisë për integrim të RIA në procesin e krijimit të politikave. *(Tabela I)*

[7] Metodologjia për vlerësim të ndikimit rregullator, Gazeta zyrtare e RM, numër 66, 28.05.2009

[8] Formulari 1: Plani për implementim të RIA; Formulari 2: RIA iniciale; Formulari 3: RIA e kompletuar

Procesi i tërësishëm i inaugurimit dhe implementimit të mëtutjeshëm të RIA rregullohet përmes dokumenteve në vijim:

- Metodologjia për vlerësim të ndikimit rregullator;
- Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të rregullores së punës së qeverisë së Republikës së Maqedonisë;
- Plani strategjik i Sekretariatit gjeneral të qeverisë së RM për periudhën 2007-2009;
- Vendimi për formën dhe përmbajtjen e formularëve për vlerësim të ndikimit rregullator.[9]

Përveç dokumenteve të mësipërme, rëndësia e RIA theksohet edhe përmes trajtimit të tij në dokumentet që vijojnë:

- Raportet vjetore të progresit nga ana e Komisionit evropian për Maqedoninë;
- Strategjia për reformën e administratës publike (2010-2015);
- Manuali për krijimin e politikave.

[9] Vendimi për formën dhe përmbajtjen e formularëve për vlerësim të ndikimit rregullator, numër 66, 28.05.2009

Tabela I. Korniza ligjore për RIA në Sllovaki, Slloveni, R. Çeke[10], dhe Maqedoni[11]

	Sllovakia	**Sllovenia**	R. **Çeke**	**Maqedonia**
Politikë eksplicite e mirratuar nga ana e qeverisë që promovon reformë rregullatore	Rregullativë më e mirë dhe Program aksionar për ulje të ngarkesës administrative mbi bizneset në Sllovaki, e miratuar me rezolutë qeveritare nr. 833, më 3.10.2007.	Strategjia për zhvillim të Sllovenisë, Qershor 2005 (masa 37: Vlerësimi i ndikimit rregullator) Programi për ulje të ngarkesës administrative, 2005	Programi nacional për reforma, 2005 Plani aksionar për ulje të ngarkesës administrative mbi bizneset, 2005	Plani strategjik i Sekretariatit gjeneral të Qeverisë së RM për 2007-2009
Institucioni përgjejgjës për rreformën rregullatore	Ministria e ekonomisë	Ministria e ekonomisë; Ministria për administratë publike	Ministria për punë të jashtme	Sekretariatit gjeneral i Qeverisë së RM Secila nga ministritë
Dokumente të miratuara nga ana e qeverisë për rregullim të RIA	**Vendime qeveritare** - **Vendim qeveritar** 241/1997(RIA e miratuar me amandamentin e vitit 2001) -udhëzime për përgaditje dhe parashtrim të materialit për seanca të qeverisë sllovake (nr. 512/2001) **Ligje** **-**Ligji për vlerësim të ndikimit mbi ambientin jetësor, 1994 (zëvendësuar me Ligjin për vlerësim strategjik të ndikimit mbi ambientin jetësor)	**Vendime qeveritare** -Programi më masa për ulje të ngarkesës administrative (nëntor 2005) -Metodologjia për implementim dhe mbikqyrje të Deklaratës për ulje të ngarkesës administrative dhe pjesëmarrje e palëve të interesuara (Tetor 2005)	**Vendime qeveritare** **-** Akte ligjore të qeverisë (nr. 188/1998) -Vendim për implementim të RIA (nr. 420/2005) -Vendim për reformë të administratës publike (nr. 237/2004) **Ligje** -Ligji për analizë të ndikimit mbi ambientin jetësor (nr.100/2001)	**Vendime qeveritare** **-** Rregullore për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për punë të qeverisë së Republikës së Maqedonisë; - Metodologjia për vlerësim të ndikimit rregullator; -Vendimi për formën dhe përmbajtjen e formularëve për vlerësim të ndikimit rregullator

[10] Katarina Staronova, Jan Pavel and Katarina Krapez 2007. *Piloting regulatory impact assessment: a comparative analysis of the Czech Republic, Slovakia and Slovenia.* <http://docserver.ingentaconnect.com/deliver/connect/beech/14615517/v25n4/s3.pdf?expires=1287494698&id=59202844&titleid=896&accname=Guest+User&checksum=F040D819503696D0E3873A8E210ECBC3>I hapur për së fundi më 19 Tetor 2010.

[11] Kombinim i autorëve

Udhëzime (manual) për RIA	-Udhëzime për përgaditje dhe parashtrim të Materialit për seanca qeveritare më Sllovaki (nr. 512/2001) -Metodologjia për përgaditje të materialebe për seanca qeveritare; -Nuk ka manuale	-Udhëzime për përgaditje të materialeve për vlerësim të ndikimit rregullator; - Nuk ka manuale	-Udhëzime për RIA, dokument i përgaditur nga Qeveria, Mars 2005; i plotësuar në Qershor, 2007. -Nuk ka manuale	-Manual për vlerësim të ndikimit rregullator
Konsultime	- Akte ligjore të qeverisë (mundësia për të komentuar u hap në vitin 2001) -Ligji për qasje të lirë në informata (procesi i konsultimeve)	-Rregullore e punës së qeverisë sllovene (Prill 2006) -Metodologjia për implementim dhe mbikqyrje mbi Deklaratën për ulje të ngarkesës administrative dhe pjesëmarrje e palëve të interesuara (Tetor 2005)	-Databaza për organizim të konsultimeve, e përgaditur nga Qeveria, 2006. -Metodologjia e detajuar për konsultime, e miratuar në Maj 2007.	-Ligji për qasje të lirë në informata -ENER
Koordinimi dhe kontrolli i kualitetit (në qeveri ose ministri)	Këshilli ligjdhënës i qeverisë, i paspecifikuar vetëm për RIA	Ministria e ekonomisë; Ministria për administratë publike	Deri 2006, njësi e veçantë në Qeveri, tani e paqartë	Sekretariati gjeneral i qeverisë
Institucion përgjegjës për parashtrim të RIA së bashku me propozim-ligjin	Министерството кое го предлага законот	Ministria që e propozon ligjin	Ministria që e propozon ligjin	Ministria që e propozon ligjin
Aspekte të mbuluara me RIA	Fiskale, punësim, ambient jetësor, ekonomike	Pa aspekte të specifikuara, pjesërisht fiskale	RIA iniciale dhe e detajuar	Ekonomike, sociale, fiskale, ekologjike

2.2 Llojet e RIA

Ministria përgjegjëse e cila propozon ligj të ri, vendimin nëse do të hartojë RIA **iniciale** ose **të kompletuar,** e merr në varësi të thellësisë së analizës së nevojshme para miratimit të ndonjë politike të re. Në raste të caktuara, edhe Sekretariati gjeneral pas vërtetimit të kompleksitetit të ligjit, mund të japë rekomandim për kalim të drejtpërdrejtë në hartimin e RIA të kompletuar. Procedurat për implementim të të dy llojeve janë identike. Dallimi i vetëm ekziston në thellësinë e analizës, resurset e angazhuara, gjatësinë e vlerësimit si dhe mënyra përmes vlerësimit të opsionit të preferuar.[12] Megjithatë, për të implementuar RIA të kompletuar, nevojitet të merren parasysh dy kriteret e mëposhtme:

- A mund propozim-ligji të shkaktojë impakte ekonomike, sociale, dhe ekologjike për një ose më shumë sektorë që rezultojnë nga zbatimi i reformave komplekse?;
- A kërkon propozim ligji mjete finansiare për implementim të tij më tepër se 600 (gjashtëqind) milionë denarë?[13]

2.3 Procesi i konsultimeve

Përfshirja e sa më shumë palëve të interesuara në mënyrë aktive në procesin e krijimit të politikave paraqet element substancial të RIA. Përmes mbajtjes së konsultimeve, propozuesit të politikave i hapet një horizont më i gjerë i mbledhjes së të dhënave dhe informacioneve që janë të rëndësishme për procesin e krijimit të një politike të caktuar dhe që të njejtat nuk është në pozitë t'i mbledhë dhe t'i analizojë në mënyrë të pavarur. Në udhëzimet për RIA që gjenden në shumë raporte të OECD-së, konsultimet llogariten si element i një rëndësie esenciale, ku më tej thuhet se publiku duhet të kyçet në procesin e konsultimeve në mënyrë permanente dhe atë duke filluar që nga fazat më të hershme të procesit të krijimit të politikave.[14]

Në Maqedoni janë të parapara dy lloje të konsultimeve: interne (ndërmjet ministrive); dhe eksterne (me të gjitha palët e interesuara) dhe të njejtat duhet të mbahen domosdoshmërisht pa marrë parasysh a bëhet fjalë për RIA iniciale ose të kompletuar.

Duke u bazuar në deklaratat e përfaqësuesve të Sekretariatit gjeneral, të cilët janë përgjegjës për monitorim dhe koordinim të procesit të RIA, konsultimet deri më tani po zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, por ekziston hapësirë për përmirësime të mëtutjeshme. Interesi i dobët i palëve të interesuara si dhe i qytetarëve në përgjithësi,

[12] Metodologjia për vlerësim të ndikimit rregullator, Gazeta zyrtare e RM, numër 66, 28.05.2009

[13] Metodologjia për vlerësim të ndikimit rregullator, Gazeta zyrtare e RM, numër 66, 28.05.2009

[14] Pedro Andres Amo, Sophie Richter-Devroe & Delia Rodrigo 2007. "*Policy Brief on Tools to Initiate RIA*" www.**oecd**.org/data**oecd**/44/26/38404544.pdf, I hapur për së fundi më 20 Tetor, 2010.

është një nga sfidat më të theksuara. Edhe përkundër mundësisë për të komentuar në aktet e vendosura online në ENER, interesimi i qytetarëve për t'u kyçur në konsultime mbetet ende në nivel shumë të ulët.

Kjo megjithatë ka të bëjë edhe me funksionalitetin jo të plotë të ENER, i cili brenda një kohe më të gjatë, për shkaqe kryesisht teknike, nuk u mundëson palëve të interesuara të regjistrohen dhe të lënë komentet e tyre. *...Dnevnik disa herë ditëve të fundit u mundua të regjistrohet në ENER, si parakusht për të komentuar mbi ndonjë akt ligjor, por përgjigjja që vazhdimisht e merrnim ishte: Profili juaj në ENER për momentin nuk është i lejuar për shfrytëzim".*[15] Eksperiencën e njejtë e ndan edhe Analytica, e cila bëri disa përpjekje për t'u regjistruar në këtë regjistër. Megjithatë, edhepse regjistrimi cilësohet si i suksesshëm, linku për aktivizim të anetarësimit dërgohet me vonesë prej më shumë se një jave.

Vërrejtjet e mësipërme janë në të njejtën vijë me vërrejtjet e Komisionit evropian për Maqedoninë. Në raportin e këtij viti thuhet se edhepse udhëzimet për RIA janë miratuar dhe nëpunësit shtetërorë të involvuar në hartim të ligjeve u janë nënshtruar trajnimeve adekuate si t'i praktikojnë të njejtat, disa ministri ende nuk organizojnë konsultime të gjera me palë të interesuara si dhe nuk përgadisin analizë sistematike për ligjet e propozuara.[16]

3. Të arriturat e deritanishme dhe sfidat në të ardhme

Para se të ceken të arriturat konkrete dhe sfidat e mëtutjeshme për zhvillimet e RIA në Maqedoni, është me rëndësi të potencohet që ky projekt ende gjendet në fazë fillestare, kështuqë analizë më e detajuar e tij mund të bëhet pas rrumbullakësimit të tre fazave të parapara:

- Faza e parë: ngritja e kapaciteteve të administratës për hartim të RIA për propozim-ligje;
- Faza e dytë: inaugurimi i RIA për akte nënligjore;
- Faza e tretë: vendosja e rrjetit ndërmjet RIA dhe Parlamentit të Republikës së Maqedonisë.

[15] ENER – Fener i fikur (ЕНЕР – Изгасен фенер) http://www.dnevnik.com.mk/default.asp?ItemID=D5E874F05DCE7D4AAA246584343DB75B. I hapur për së fundi më 25 Tetor, 2010.

[16] Raporti i progresit të Komisionit Evropian për Maqedoninë (2010). http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/mk_rapport_2010_en.pdf. I hapur për së fundi më 10 Nëntor, 2010.

Për momentin po zhvillohet faza e parë – ngritja e kapaciteteve të administratës për hartim të RIA për propozim-ligje, andaj të dhënat që jepen më poshtë kanë të bëjnë vetëm me këtë fazë.

3.1 Të arriturat më të rëndësishme

Krahas inaugurimit dhe integrimit të RIA në procesin e krijimit të politikave, i cili paraqet sukses më vete, rrjedha e deritanishme e ngjarjeve në procesin e RIA karakterizohet me një sërë suksesesh komplementare, ku mund të veçohen:

- ✓ Integrimi i RIA në procesin e krijimit të politikave;
- ✓ Miratimi i kornizës ligjore e kualitatetit të lartë për implementim të RIA, e cila mundëson hartim kualitativ të RIA;
- ✓ Ngritja e kapaciteteve të administratës për hartim të RIA për propozim-ligje;
- ✓ Krijimi dhe inaugurimi i web-portalit ENER për informim të palëve të interesuara dhe qytetarëve për të gjitha aktet e propozuara si dhe dhënia e mundësisë për të dhënë komente dhe propozime;
- ✓ Përgaditja e një manuali për RIA me kualitet të jashtëzakonshëm, me mbështetje të Ambasadës britaneze.

3.2 Sfidat e mëtutjeshme

Progresi i arritur deri më tani në lidhje me RIA megjithatë ende nuk është i mjaftueshëm që e tërë pasqyra të tregohet si ideale. Vetë analiza e bërë përmes këtij hulumtimi dhe opinionet e marra nga ana e aktorëve kyç për RIA tregojnë se krahas progresit të arritur, rruga për gjetjen e një modusi solid për implementim të RIA në Maqedoni është relativishtë e gjatë dhe përplot me sfida, ku veçohen:

- ➲ Përforcimi i implementimit të kornizës ligjore për RIA me çka do të përmirësosheshte kualiteti i përgaditjes së RIA;
- ➲ Shpallja në kohë e të gjitha akteve të propozura nga ana e ministrive si në ENER ashtu edhe në webfaqet e tyre;
- ➲ Ndërtimi i databazave të reja për të dhëna të përgjithshme. Të dhënat ekzistuese në Entin e statistikave janë të pamjaftueshme për të hartuar RIA kualitative, gjë që shpesh-herë paraqitet si arsye kryesore që çon deri te plotësimi i formularëve të RIA me një përgjigje të vetme “nuk ka ndikim”;
- ➲ Shfaqja e proaktivitetit dhe vet-iniciativës nga ana e komunitetit të biznesit dhe palëve tjera të interesuar për të marrë pjesë në procesin e konsultimeve;

- Ndërprerja e praktikës së miratimit të ligjeve me procedurë të rregullt brenda afateve kohore shumë të shkurtëra;
- Vazhdimi i praktikës së vendosur për mbajtje të trajnimeve për administratën;
- Përmirësimi urgjent i funksionalitetit të ENER-it me çka palëve të interesuara dhe qytetarëve do t'u mundësohet pjesëmarrje aktive në procesin e krijimit të politikave;
- Publikimi i arsyetimeve për opinione të pranuara dhe te papranuara, të dërguara nga ana e palëve të interesuara dhe qytetarëve përmes ENER. Kjo do të bënte që mundësimi i kyçjes së qytetarëve dhe palëve të interesuara në procesin e krijimit të politikave nuk është vetëm formalitet, por vlerë që kontribuon për rregullativë më kualitative;
- Promovimi i RIA përmes mediumeve me qëllim të njohjes së publikut më të gjerë me rolin dhe domethënien e RIA, si dhe të rritet interesi i qytetarëve për pjesëmarrje aktive në procesin e krijimit të politikave;
- Kalimi sa më i shpejtë në fazën tjetër të RIA: hartim i RIA për akte nënligjore dhe projekte tjera;
- Vendosje e rrjetit ndërmjet RIA dhe Parlamentit të Maqedonisë, me çka përmes kqyrjes në RIA dokumentin e përgaditur, Parlamenti do të mund të vërtetojë kualitetin e zgjidhjes së propozuar ligjore;
- Kyçja më masive e sektorit joqeveritar në tërë procesin e përgaditjes së ligjeve, përmes konsultimit të analizave dhe raporteve të përpunuara nga ana e tyre, dhe që janë relevante për ndonjë akt të caktuar.

4. Bibliografia

1. Metodologjia për vlerësim të ndikimit rregullator, Gazeta zyrtare e RM, numër 66, 28.05.2009
2. Plani strategjik i Sekretariatit gjeneral të Qeverisë së RM për 2007-2009
3. Rregullore për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për punë të qeverisë së Republikës së Maqedonisë;
4. Vendimi për formën dhe përmbajtjen e formularëve për vlerësim të ndikimit rregullator;
5. Strategjia për reformë të administratës publike (2010-2015);
6. Manuali për krijim të politikave;
7. Manuali për vlerësim të ndikimit rregullator, Shkup, 2009;
8. Raporti i progresit të Komisionit Evropian për Maqedoninë (2010). http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/mk_rapport_2010_en.pdf
9. The 1995 OECD Checklist for Regulatory Quality, http://www.oecd.org/officialdocuments/displaydocument/?doclanguage=en&cote=OCDE/GD(95)95
10. Regulating Better: A Government White Paper setting out six principles of Better Regulation. January 2004. http://www.betterregulation.ie/eng/Government_White_Paper_'Regulating_Better'/RegulatingBetterGovernmentËhitePaper1.pdf
11. Katarina Staronova, Jan Pavel and Katarina Krapez 2007. "*Piloting regulatory impact assessment: a comparative analysis of the Czech Republic, Slovakia and Slovenia."*
12. Pedro Andres Amo, Sophie Richter-Devroe & Delia Rodrigo 2007. "*Policy Brief on Tools to Initiate RIA"*
13. ENER – Fener i fikur (ЕНЕР – Изгасен фенер) http://www.dnevnik.com.mk/default.asp?ItemID=D5E874F05DCE7D4AAA246584343DB75B
14. Auke Haagsma, European Commission, Internal Market DG 2001. "Acceptable Law-Making Standards in the European Union their Regulatory Assessment"

15. Sue Holmes, Regulatory Management and Reform Public Management Service OECD, 2001. “The best practices on Regulatory Impact Analysis in OECD countries: Some options for RIA”

16. Claudio M. Radaelli and Fabrizio De Francesco, University of Exeter, 2008. “The Oxford Handbook on Regulation, Chapter 15 - Regulatory Impact Assessment.”

17. N. Malevska, intervistë personale, 19 Tetor, 2010;

18. N. Shikova, intervistë personale, 19 Tetor, 2010;

19. M. Jovanovska, intervistë personale, 29 Tetor, 2010;

20. M. Simonovska, intervistë personale, 29 Tetor, 2010;

21. J. Ivanova, intervistë personale, 8 Nëntor, 2010;

22. M. Esati, intervistë personale, 8 Nëntor, 2010;

23. A. Popovski, intervistë personale, 10 Nëntor, 2010;

24. www.ener.gov.mk

POLICY BRIEF

Programi për analizë të politikave dhe administratës publike

"Përforcimi rolit të RIA në procesin e krijimit të politikave në Maqedoni"

Agim Selami, *Hulumtues i programit*
aselami@analyticamk.org

Contact

Adress:
Dame Gruev
No: 7-8/3
1000 Skopje, Macedonia
Tel: 00389 (0)2 3121 948
Fax: 00389 (0)2 3121 948

E-mail: info@analyticamk.org